

VENDIM
Nr. 202, datë 5.3.2020

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE
RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO
NDËRHYRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE
BANESAVE**

(Ndryshuar me VKM nr. 306, datë 15.4.2020; nr. 336, datë 23.4.2020; nr. 374, datë 6.5.2020; nr. 643, datë 3.8.2020; nr. 759, datë 23.9.2020; nr. 1101, datë 16.12.2020; nr. 1132, datë 24.12.2020; nr. 406, datë 30.6.2021; nr. 426, datë 8.7.2021; nr. 590, datë 13.10.2021; nr. 772, datë 15.12.2021; nr. 184, datë 30.3.2022)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të nenit 13, dhe të nenit 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 7 570 789 865 (shtatë miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale dhe ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë njërive zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në masën 5 430 065 414 (pesë miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e katërmbydhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 2 140 724 451 (dy miliardë e njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

2.1 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 3 757 881 137 (tre miliardë e shtatëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e tetëdhjetë e një mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 2 492 978 390 (dy miliardë e katërqind e nëntëdhjetë e dy milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e treqind e nëntëdhjetë) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi prej 1 264 902 747 (një miliard e dyqind e gjashtëdhjetë e katër milionë e nëntëqind e dy mijë e shtatëqind e dyzet e shtatë) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim,

ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

2.2 Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2021, do të jetë në masën 1 538 821 704 (një miliard e pesëqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekë pa TVSH, nga i cili:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 663 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi prej 875 821 704 (tetëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e tetëqind e njëzet e një mijë e shtatëqind e katër) lekësh pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

Efekti financiar do të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.

2.3. Fondi që do të përdoret, i miratuar në buxhetin e vitit 2022, do të jetë në masën 476 247 021 (katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e dyzet e shtatë mijë e njëzet e një) lekë pa TVSH, i cili do t'i shtohet Fondit Shqiptar të Zhvillimit në buxhetin e miratuar për vitin 2022, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër, në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

3. Fondet e mbetura të papërdorura, pas përfundimit të procedurave të prokurimit në zbatim të këtij vendimi, kthehen në zërin “Fondi për rindërtim” të buxhetit të shtetit.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**